



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:027194
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05611357

C.nr.607/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve Insig Sh.a. në likuidim, me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga likuidatori L.B., e të cilët i përfaqëson L. I., jurist në kompani, kundër të paditurit A.G. nga P. Rr. ... me bazë juridike kthim i borxhit, vlera e kontestit 5,500 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurit, me datë 12.04.2024 mori, kurse me datë 24.04.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve Insig sh.a. në likuidim me seli në Prishtinë, kundër të paditurit A.G. nga P. dhe DETYROHET i padituri që paditëses në emër të borxhit ë datës 18.10.2017 të ia kthejë shumën prej 5,500 euro, me kamatë ligjore prej 8% të llogaritur nga data e ngritjes së padisë (24.02.2020) e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë e nën kërcënim përmbarimi.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

I. Historiku i procedurës:

Paditësja Kompania e Sigurimeve Insig në likuidim, me seli Prishtinë e përfaqësuar nga likuidatori L.B., e të cilët i përfaqëson L. I., jurist në kompani, kundër të paditurit A.G. nga P. Rr. ..., ka ngritur padi me bazë juridike kthim i paradhënies, vlera e kontestit 5,500 euro.

II. Pretendimet e ndërgjyqësve

Paditësja, me padi ka theksuar se bazuar në urdhrin me numër 17 e datës 18.10.2017, është kërkuar paradhënia e kryeshefit ekzekutiv dhe drejtorit të drejtorisë së shitjes dhe marketingut në shumën prej 11,000 euro, ku 5,500 euro janë kërkuar në formë të paradhënies për A.G. – kryeshef ekzekutiv, kurse 5,500 për B.K. si drejtor i drejtorisë së shitjes dhe marketingut. Sipas këtij urdhri, është paraparë që paradhënia e dhënë do të mbyllet në baza mujore e duke filluar nga janari 2018. Me datë 18.10.2017, nga llogaria bankare e Insig Sh.a. dega në Kosovë, është kryer transfer në shumën prej 5,500 euro, kurse i padituri ka qenë i obliguar që nga janari i viti 2018 të fillojë kthimin e kësaj paradhënie, por që kjo gjë nuk ka ndodhur. Me datë 18.10.2019, paditësja i është drejtuar me kërkesë për kthimin e këtyre mjeteve, por i padituri nuk është përgjigjur. Gjatë seancave, kanë mbetur në tërësi pranë padisë, kurse në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses ka cekur se ky urdhër është kërkuar dhe nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv A.G., i cili obligimin ka pas që ta kthejë duke filluar nga janari 2018. Në vitin 2019, kur kompania ka shkuar në likuidim, është parë se i njëjti borxhin e ka marrë dhe nuk e ka rikthyer ashtu siç ka kërkuar vetë, andaj gjykatë i ka propozuar që padia të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet i padituri të kthejë paradhënien në shumë prej 5,500 euro, me kamatë ligjore siç e aplikojnë bankat e në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I padituri, ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi me datë 15.05.2024, kurse nuk ka paraqitur përgjigje në padi. Po ashtu, i padituri edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata për seanca gjyqësore, nuk ka prezantuar asnjëherë, ashtu që seanca përgatitore dhe e shqyrtimit kryesor, është mbajtur në mungesë të paditurit, konform nenit 409.2 dhe 423.4 të LPK-së.

III. Provat e administruara nga gjykata

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike, sipas propozimit të palëve, në procedurën e të provuarit, i ka administruar këto prova: urdhri me numër 17 i datës 18.10.2017 mbi dhënien e një paradhënie krye shefit ekzekutiv dhe drejtorit të drejtorisë së shitjes dhe marketingut, urdhër transferi i datës 18.10.2017 në llogarinë e përfituesit A.G. nga urdhëruesi Insig në shumë prej 5,500 euro, kërkesa për debitim të mjeteve financiare në shumë prej 5,500 euro për B.K. dhe kërkesa për kthim të paradhënies sipas urdhrit me numër 17 e datës 18.10.2019.

IV. Vlerësimi faktik dhe juridik i gjykatës

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Pasi që pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi e as që ka marrë pjesë në seanca gjyqësore, gjykata nuk ka arritur që të përcaktoj nëse në mes të palëve ndërgjyqëse ka pasur apo jo fakte kontestuese, e në këtë kuptim, të gjitha faktet e paraqitura nga pala paditëse i ka konsideruar si kontestuese.

Nga urdhri me numër 17 i datës 18.10.2017 mbi dhënien e një paradhënie krye shefit ekzekutiv dhe drejtorit të drejtorisë së shitjes dhe marketingut, gjykata vërtetoi se i padituri A.G., në cilësinë e drejtorit, kishte nxjerrë këtë urdhër, për dhënien e një shumë të hollave 2 x 5,500 në formë të paradhënies z. A.G. (pra vetvetes) si krye shef ekzekutiv dhe z. B.K. si drejtor i drejtorisë së shitjes dhe marketingut, në degën Insig sh.a në Kosovë. Sipas këtij urdhëri, paradhënia do të mbyllet në baza mujore e duke filluar nga janari i vitit 2018, kurse ekzekutimin e këtij urdhri do ta bëjë drejtoria për financa dhe kontabilitet.

Përmes urdhër transferit të datës 18.10.2017 në llogarinë e përfituesit A.G. nga urdhëruesi Insig në shumë prej 5,500 euro, gjykata vërtetoi se me këtë datë, shuma e të hollave prej 5,500, ishte debituar në llogarinë e të paditurit A.G. në Raiffeisen Bank, e nga llogaria e paditëses Insig Dega në Kosovë, kurse nga kërkesa për debitim të mjeteve financiare në shumë prej 5,500 euro për

B.K., gjykata vërtetoi se në përmbushje të urdhrit të paditurit, ishte paraqitur kërkesa që një pagesë e tillë të i përmbushet edhe personit B.K..

Nga kërkesa për kthim të paradhënies sipas urdhrit me numër 17 të dt.18.10.2017 e datës 18.10.2019 me numër protokollit 2369, gjykata vërtetoi se pala paditëse nga i padituri kishte kërkuar kthimin e mjeteve që janë objekt i këtij kontesti dhe se kjo kërkesë ishte paraqitur nga likuidatori i kompanisë, ku të paditurit i ishte kërkuar që kthimi i mjeteve të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese. Pavarësisht kësaj, gjykata në shkresat të lëndës, nuk kishte ndonjë dëshmi, nëse i padituri ka pranuar ndonjëherë këtë kërkesë për kthim të paradhënies.

Këtyre provave, gjykata u ka falur besimin, duke përjashtuar kërkesën për kthim të paradhënies, pasi që nuk kemi ndonjë provë tjetër e cila do të vërtetonte se i padituri ka pranuar apo jo këtë kërkesë, kurse provat e tjera për gjykatën janë paraqitur të besueshme

Fillimisht, lidhur me trajtimin kërkesëpadisë së palës paditëse, edhe pse e njëjta është paraqitur si paradhënie dhe urdhri për dhënien e kësaj paradhënie e ka quajtur si të tillë, gjykata në bazë të nenit 2.2 të LPK-së, nuk është e lidhur në thëniet e palëve në procedurë sa i përket bazës ligjore, andaj në këtë rast ka aplikuar dispozitat ligjore nga neni 8 i Ligji nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku në nenin 8 parag.1 parasheh se *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”*, ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LDM-së, ka paraparë se *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, e sipas nenit 305 par.1 të LMD-së *“Debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje”* kurse sipas nenit 375 të LMD-së *“Kur detyrimi ka si subjekt një shumë të hollash, debitori ka për detyrë të paguajë shumën e njëjtë të hollave, përveç nëse kreditori dhe debitori merren vesh ndryshe në pajtim me ligjin.”*

Në këtë kuptim, i padituri, me anë të urdhrit numër 17 i datës 18.10.2017 mbi dhënien e një paradhënie krye shefit ekzekutiv dhe drejtorit të drejtorisë së shitjes dhe marketingut, kishte vendosur që vetvetes dhe një personi tjetër, në formë të paradhënies, të ia jepte shumën e të hollave nga 5,500 euro për secilin, e të cilat i padituri pjesën e vet kishte për obligim që ta kthente nga fillimi i muajit janar të vitit 2018 e në baza mujore. Se i padituri kishte inkasuar

këtë shumë në llogarinë e tij personale, u vërtetua përmes urdhër pagesës së datës 18.10.2017, por që më pas këtë shumë nuk e kishte kthyer asnjëherë tek pala paditëse.

Gjykata, konstaton se borxhi është bërë i kërkueshëm dhe ka arritur për përmbushje, që nga janari i vitit 2018, e pasi që nuk ka një afat se kur duhet të behet përmbushja definitive e borxhit (mbyllja), gjykata atëherë konform nenit 245 të LMD, konstaton se kërkesa ka arritur për përmbushje në momentin kur kreditori e ka kërkuar atë, në këtë rast me paraqitjen e padisë me datë 24.02.2020, për shkak se kërkesa me të cilën të paditurit i është kërkuar kthimi i borxhit, nuk dihet nëse ky i fundit e ka pranuar apo jo.

Tutje, referuar nenit 286.1 të LMD-së, përcaktohet se “1. Përmbushja medoemos duhet t’i bëhet kreditorit ose personit të caktuar me ligj, me vendim gjyqësor, me kontratë midis kreditorit e debitorit, ose nga vetë kreditori”, ku në këtë rast si kreditor na paraqitet pala paditëse, kurse debitor i padituri.

Fakte vendimtare në këtë çështje kontestimore, na janë paraqitur nëse pala e paditur ka pranuar shumën e të hollave prej 5,500 euro, e cila u vërtetuar përmes urdhër pagesës si dhe nëse i padituri ka dështuar që të kthejë këto të holla sipas kërkesës së paditësit, ku nga administrimi i provave, ka rezultuar se i padituri nuk ka përmbushur obligimin e tij.

Duke ju referuar dispozitës së nenit: 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të ligjit të procedurës kontestimore, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t’i provoji faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Pala e paditur me këtë rast, kishte lëshuar mundësinë e dhënies së prapësimeve materiale apo edhe procedurale në këtë procedurë.

Gjykata vendimin lidhur me kamatën e gjykuar e mbështet në dispozitat e nenit 382 par.1 të LMD- se “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, ku gjykata ka pranuar si moment të fillimit të llogaritjes së kamatës ditën e parashtrimit të padisë me datë 24.02.2020, duke ia njohur paditëses kamatën vjetore prej 8%, sipas kërkesës së saj e jo sipas kamatës ligjore të cilën e aplikojnë bankat, sepse një kërkesë e tillë është pa bazë ligjore, kurse kamatës ligjore që i është referuar pala paditëse, është ajo prej 8 %.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur komfor nenin 449 dhe 463 të LPK-së së, sepse pala paditëse nuk i ka kërkuar shpenzimet e specifikuar.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:027194, C.nr.607/22, Dt.24.04.2024

Gjyqtari
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.